

## **Appendix A to Part 92—Sample Notice Informing Individuals About Nondiscrimination and Accessibility Requirements and Sample Nondiscrimination Statement:**

### **Discrimination is Against the Law**

[Name of covered entity] vepron në përputhje me ligjet e zbatueshme federale të të drejtave civile dhe nuk ushtron diskriminim mbi baza si raca, ngjyra, prejardhja etnike, mosha, aftësia e kufizuar ose gjinia. [Name of covered entity] nuk i përjashton personat ose nuk i trajton ata në mënyrë të diferencuar për shkak të racës, ngjyrës, prejardhjes etnike, moshës, aftësisë së kufizuar ose gjinisë.

[Name of covered entity]:

- Ofron ndihmë dhe shërbime falas për personat me aftësi të kufizuara për të komunikuar në mënyrë efektive me ne, si p.sh.:

- Interpretues të kualifikuar të gjuhës së shenjave
- Informacione me shkrim në formate të tjera (me germa të mëdha, audio, formate elektronike të aksesueshme, formate të tjera)

- Ofron shërbime gjuhësore falas për personat që nuk kanë anglishten si gjuhë të parë të tyre, si p.sh.:

- Interpretues të kualifikuar
- Informacione me shkrim në gjuhë të tjera

Nëse ju nevojiten këto shërbime, kontaktoni me [Name of Civil Rights Coordinator]

Nëse besoni se [Name of covered entity] ka dështuar në ofrimin e këtyre shërbimeve apo ju ka diskriminuar në një mënyrë tjetër në bazë të racës, ngjyrës, prejardhjes etnike, moshës, aftësisë së kufizuar apo gjinisë, ju mund të depozitoni një ankesë pranë: [Name and Title of Civil Rights Coordinator], [Mailing Address], [Telephone number ], [TTY number—if covered entity has one], [Fax], [Email]. Ankesën mund ta depozitoni personalisht ose ta dërgoni me postë, faks ose email. Nëse ju nevojitet ndihmë për depozitim të një ankese, [Name and Title of Civil Rights Coordinator] do të jetë në dispozicionin tuaj për t'ju ndihmuar.

Ju mund të depozitoni gjithashtu një ankesë për të drejtat civile pranë U.S. Department of Health and Human Services (Departamenti Amerikan i Shërbimeve të Shëndetit dhe Njeriut), Office for Civil Rights (Zyra për të Drejtat Civile), në mënyrë elektronike përmes Office for Civil Rights Complaint Portal, që gjendet në adresën <https://ocrportal.hhs.gov/ocr/portal/lobby.jsf>, ose me postë apo telefon në:

U.S. Department of Health and Human Services

200 Independence Avenue, SW

Room 509F, HHH Building

Washington, D.C. 20201

1-800-368-1019, 800-537-7697 (TDD)

Formularët e ankesave gjenden në adresën <http://www.hhs.gov/ocr/office/file/index.html>.